



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhës për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.105/ 2011

Paneli Zgjedhës për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, të paraqitur për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR) në Fushë Kosovë, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë me datë 25.01.2011 nga subjekti politik LVV në të cilën theksohet se me datën 24.01.2011 gjatë procesit të numërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ka pasur parregullsi në kutin e QV 1104B/09R ku pas mbylljes është hapur prapë për arsye të një zarfi, shiriti i mesit i kutisë me nr. 286555 ndërrimet me shiritin nr. 288555, 1105B/04R ndërrim i shiritave të kutisë, 1107B/02D shiriti ka qenë i këputur, 1112B04 është bërë ndërrimi i shirave pa arsye, 1112B/01R ndërrim i shiritave, 1113B/01R në karantine e pa plotësuar, 1115B/01R fleta e punës mungon dhe 1117B/02D ndërrim shiritave. Si dhe në VV 1121b/02D, nga Zyrtari i KKZ –se janë përmirësuar numrat e shiritave të kutisë meqenese thuhet se janë dëmtuar.

**Neni 106 paragrafi 1 dhe 2 i LZP-së, specifikon se:**

*106 I “KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jete vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës”.*

106.2 "Para certifikimit te rezultatit te zgjedhjeve, KQZ-ja mund te urdhërojë rinumërimin e votave ne cilindo vendvotim, qendër te numërimit ose edhe përsëritjen e votimit ne një qendër votimi apo ne një komune".

#### **Neni 4.2 i Rregullave dhe Procedurave te PZAP parasheh si vijon:**

4.2 PZAP-i mund t'i hidh poshtë (si të palejuara, të parregullta apo të pasafatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore. Në rast se ankesa nuk i plotëson këto kriteret, PZAP-i mund t'i japë palës ankuese një periudhë të arsyeshme kohore, siç është paraparë në njoftim, për t'i plotësuar ato kriteret.

PZAP gjeti se:

**- ankesa është e palejuar**

Bazuar ne faktin se certifikimi i rezultateve preliminare është i pa përfunduar, PZAP gjykon se ankesa e subjektit politik LVV, nuk është e lejuar. Prandaj ne këtë faze te procedurës, interesi ligjor i palës mund te ndryshoj ne varësi sipas shpalljes se rezultateve nga QNR-KQZ si dhe për parregullsitë e pretenduara do të bëhet auditimi paralelisht me futjen e bazës së të dhënave në sistem. Prandaj PZAP gjykon se ankesa e subjektit politik LVV ne këtë faze te procedurës se procesit zgjedhor është e parakohshme dhe si pasoje është hedhur poshtë si e palejuar. Për këto arsye si dhe bazuar ne dispozitat ligjore te cituara me larte dhe ne kuptim te nenit 115.1 te LPZ-se, PZAP vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr.105/2010 më datën 26.01.2011.

